



Prishtinë: 24.03.2010

Kodi i ZRRE-së: V_232_2010

Nr. i Referencës: ZRRE/DMK_R_376_03_10

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke marrë parasysh

1. Kompetencat e Zyrës së Rregullatorit për Energji të dhëna në nenin 17 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë;
2. Dispozitat sipas Kapitullit 3, nenit 16 të Rregullës mbi Procedurën e Zgjidhjes së Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
3. Dëshmitë dhe procedurat e paraqitura nga palët;
4. Rekomandimin e DMK të ZRRE-ë: ZRRE/DMK_R_376_06_08; dhe
5. Nenin 18 të Rregullës mbi Procedurën e Zgjidhjes së Kontesteve në Sektorin e Energjisë.

Në mbledhjen e mbajtur më 24 mars 2010, nxori këtë:

VENDIM

PRANOHET ankesa e konsumatorit Halim Krasniqi (shifra e konsumatorit në KEK: DPR – 90023920) nga Prishtina si në arsyet e paraqitura të këtij vendimi.

Arsyetim

Konsumatori në ankesën e tij drejtuar DMK-së në ZRRE me datë 18.08.2008 ka apeluar heshtjen administrative të KEK-ut lidhur me kundërshtimin e faturave të energjisë elektrike prej periudhës 10/2005.

- Me datë 08.03.2008 zyrtarët e autorizuar të energjisë elektrike kanë inspektuar pikën matëse te konsumatori dhe kanë konstatuar se gjatë kontrollimit të faturave konsumatori shpenzon 0 KWh për periudhën 01/2008, njehsori i konsumatori të lartshënuar është i kyçur në rrjetin elektrik por nuk shpenzon energji elektrike sepse lokali është i mbyllur dhe nuk ushtron veprimtari nga periudha 10/2005. Konsumatori ka parashtruar ankesë me datë 28.12.2007 pasi që njehsori ka qenë pasiv e pastaj kanë filluar t'i arrijnë faturat.

Provë: Procesverbali nr. 0126161 i datës 08.03.2008

- Me datë 18.03.2008 konsumatori ka parashtruar ankesë në Departamentin për Konsumator në KEK duke kundërshtuar faturat e energjisë elektrike prej periudhës 10/2005.

Provë: Ankesa e konsumatorit në KEK

- Me datë 18.08.2008 konsumatori ka apeluar heshtjen administrative të KEK-ut

Provë: Ankesa e konsumatorit në DMK të ZRRE-së

DMK në ZRRE duke analizuar të gjitha dëshmitë e paraqitura nga ana e konsumatorit dhe KEK-ut, ka vërejtur se:

- ✓ Sipas transaksioneve të konsumatorit shihet se konsumatori është faturuar me energji elektrike çdo muaj e çdo vit dhe se nuk vërehet se njehsori elektrik i konsumatorit ka qenë pasiv.
Provë: Transaksionet e konsumatorit
- ✓ Nga transaksionet e konsumatorit shihet se me datë 29.07.2005 konsumatori ka bërë një pagesë në KEK në vlerë prej 85.00 €, për të paguar borxhin e energjisë elektrike, borxhi deri me atë datë ka qenë 84.71 € dhe se sipas kësaj shihet se në borgjin e përgjithshëm me atë pagesë konsumatori ka qenë -0.29 €.
Provë: Transaksionet e konsumatorit
- ✓ Sipas procesverbalit të KEK-ut nr. 0126161 të datë 04.03.2008 punëtorët e autorizuar të KEK-ut kanë inspektuar pikën matëse te konsumatori dhe kanë konstatuar se gjatë verifikimit të faturave me shpenzim zero kilovatorë për janar 2008 vërtetuar se njehsori elektrik është i kyçur në rrjetin elektrik por nuk shpenzon energji elektrike sepse lokali është mbyllur nuk ushtron veprimtari nga viti 2005 muaji i dhjetë. Ekipi i KEK-ut ka theksuar se konsumatori ka bërë ankesë me datë 28.12.2007 pasi që njehsori ka qenë pasiv e pastaj kanë filluar ti shkojnë faturat.
Provë: Procesverbali i KEK-ut nr. 0126161 të datës 04.03.2008
- ✓ Sipas rrjedhjes së energjisë aktive shihet se prej periudhës 12/2004 nuk ka shpenzim të energjisë elektrike deri më 10/2008, gjatë kësaj periudhe konsumatori është faturuar vetëm taksën për RTK e pastaj edhe me tarifën fikse.
Provë: Rrjedhja e energjisë aktive dhe transaksionet e konsumatorit
- ✓ Sipas listave të leximit vërehet se prej periudhës 12/2004 lexuesi i KEK-ut e ka evidentuar se lokali është i mbyllur dhe se nuk ka shpenzim të energjisë elektrike.
Provë: Listat e leximit
- ✓ Në procesverbalin e KEK-ut nr. 0126161 të datës 04.03.2008 punëtorët e autorizuar të KEK-ut kanë inspektuar pikën matëse te konsumatori, ku gjendja e njehsorit në momentin e kontrollimit ishte TI=801 KWh dhe TII=03525 KWh, gjë që kjo gjendje e njehsorit përputhet me gjendjen e rrjedhjes së energjisë aktive dhe listave të leximit.
Provë: Procesverbali i KEK-ut nr. 0126161 të datës 04.03.2008
- ✓ Sipas deklaratës së konsumatorit thekson se ai ka shkuar në KEK për tu njoftuar se si është procedura e mbylljes së llogarisë (pasivizimin) me KEK-un ashtu që të mos faturohet më për arsye se lokali nuk punon më. Sipas deklaratës së konsumatorit punëtorët e KEK-ut i kanë theksuar se konsumatori duhet vetëm të paguaj borxhin total të energjisë elektrike në shifrën DPR – 90023920 deri në atë moment. Konsumatori është pajtuar të paguaj borxhin total, ku me datë 29.07.2005 konsumatori ka paguar borxhin komplet dhe se ka kërkuar që tani e tutje të mos faturohet ajo shifër ngase lokali është i mbyllur dhe se nuk ushtrohet ndonjë veprimtari.

DMK në ZRRE pas analizimit të dëshmive të paraqitura rekomandon Bordit të ZRRE-së që të **pranon** ankesën e konsumatorit.

Bordi i ZRRE-së ka rishikuar të gjitha dokumentet e paraqitura dhe ka vendosur që ta **pranojë** ankesën e konsumatorit për arsyet e paraqitura në rekomandimin e DMK të ZRRE-së.
Sipas këtij vendimi, KEK-u është i obliguar që

1. KEK-u duhet ta shkarkoj konsumatorin nga faturat e energjisë elektrike prej periudhës 07/2005 e deri 10/2008.

Këshillë Juridike: Kundër këtij Vendimi, pala ka të drejtë të iniciojë procedurë gjyqësore në Gjykatën Kompetente, brenda **katërmëdhjetë (14) ditësh** prej ditës së pranimit të këtij Vendimi.

Bordi i ZRRE-së

Dr. Ali Hamiti, kryesues

Theranda Beqiri, anëtare

Përparim Kabashi, anëtar

Blerim Koci, anëtar